



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, (ASE) NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 561 i vendimit Data 18.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

VËREN

Partia Socialiste e Shqipërisë, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë, Përrenjas, Mirëditë, Kavajë, Rogozhinë, Skrapar, Maliq, Pogradec, Pustec, Polican, Gramsh, Kucovë, Fushë Arrës, Vau i Dejës, Pukë, Delvinë, Berat, Përmet, Mallakastër, Bulqisë, Këlcyrë, Sarandë, Cërrik, Klos, Dropull, Krujë, Kurbin, Gjirokastër, Belsh, Memaliaj, Finiq, Shijak, Libohovë, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, për këto bashki : Mirëditë, Kavajë, Rogozhinë, Skrapar, Maliq, Pogradec, Pustec, Polican, Gramsh, Kucovë, Fushë Arrës, Vau i Dejës, Pukë, Delvinë, Berat, Përmet, Mallakastër, Bulqisë, Këlcyrë, Sarandë, Cërrik, Klos, Dropull, Krujë, Gjirokastër, Belsh, Memaliaj, Finiq, Shijak, Libohovë, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- a. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, për bashkinë Kurbinë rezulton se ka deklaruar vetëm nr. Rendor 31 ka deklaruar ndalim nga komisarati nr. 4 Tiranë në datë 11.01.2011.
- b. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, për bashkinë Përrenjas, rezulton se:
 - Nr. 1 Haxhi Avni Çollaku, në pikën 4. ka deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Elbasan, është mbajtur 72 ore mase sigurie të cilën e ka shënuar të rezultatet, periudha 22.01.2019 – 25.01.2019. Në pikën 5, ka deklaruar mase shtrenguese "detyrim paraqitje" nga Gjykata Elbasan, për kryerjen e vepres penale "Aksident Rrugor", parashikuar nga neni 290 I K.P, është në process hetimi.
 - NR. 2 Medi Sali Hana, ka deklaruar se është proceduar nga Prokuroria Elbasan, është mbajtur 72 ore mase sigurie, periudha e hetimit 16.10.2018 – 20.10.2018, në pikën 5, ka deklaruar mase shtrenguese "detyrim paraqitje" mase e cila është revokuar, për kryerjen e vepres penale "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 245/1 dhe 25 I K.P, është në process gjykimi.
 - Nr. 19 Fatos Nezha ka deklaruar dënim me gjobë 50,000 lekë nga Gjykata Korçë , vendim I vitit 2002, për veprën penale "tejkalim i kompetencave të punonjesit të policisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe



Nr. 561 i vendimit Data 18.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- a. Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, për bashkitë, Përrenjas, Mirëditë, Kavajë, Rogozhinë, Skrapar, Maliq, Pustec, Polican, Gramsh, Kucovë, Delvinë, Berat, Përmet, Mallakastër, Bulqisë, Këlcyrë, Sarandë,, Cërrik, Klos, Dropull, Krujë, Belsh, Memaliaj, Finiq, Shijak, sipas së cilës rezultojnë sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare.
- b. Zyra e gjendjes gjyqësore me shkresën me nr. 3615/1 prot., datë 16.05.2019 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, Fushë Arrës, Vau i Dejës, Pukë, Pogradec, Kurbin, Libohovë, Gjirokastër sipas të cilës rezultoi se :

- **Bashkia Gjirokastër, Gentjan Llogo me nr.8** rendor në bazë të vendimit më nr. 70 datë 15.05.2006 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Shpërdorim të detyrës". Në bazë të nenit 248 K.p dënohet me 300 mijë lekë gjobë. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P.
- **Bashkia Libohovë, Andi Ruçi me nr. 10** rendor në bazë të vendimit më nr. 63 datë 15.02.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Organizim të llotarive të palejuara". I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P.
- **Bashkia Kurbin, Artur Bardhi me nr. 2** Rendor në bazë të vendimit më nr. 124 datë 10.09.1990 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Kalim i Paligjshëm i kufirit". Në bazë të nenit 127 dhe 11/1 K.p dënohet me 1 muaj dhe 15 ditë burgim. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P.
- **Bashkia Pukë, Bardhok Frroku me nr. 10** rendor në bazë të vendimit më nr. 69 datë 22.09.2003 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Përmbajtje pa leje të lëndëve plasëse". Në bazë të nenit 278/2 K.p dënohet me 2 muaj burgim. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P.
- **Bashkia Fushë- Arrës, Marie Nikolli me nr. 11** rendor në bazë të vendimit më nr. 52 datë 24.10.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Falsifikim i dokumentave shkollorë". Në bazë të nenit 187/1 K.p dënohet me 80 mijë lekë. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P.
- **Bashkia Pogradec, Alfons Culi me nr. 27** rendor në bazë të vendimit më nr. 190 datë 16.02.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike". Në bazë të nenit 275 K.p dënohet me 600 mijë lekë gjobë. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P.
- **Bashkia Vau i Dejës:**
 1. David Huba me nr. Rendor në bazë të vendimit më nr. 41, datë 08.02.2005 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale, Falsifikim të dokumenta shkollor. Në bazë të nenit 187/1 K.p denohet me 300 mijë lekë gjobe. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P
 2. Dylaver Murriqi me nr 46, në bazë të vendimit më nr. 111, datë 09.02.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Drejtimit i automjetit në mënyrë të parregullt". Në bazë të nenit 281 K.p denohet me një muaj burgim. I rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.P



Nr. 561 i vendimit Data 18.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Bashkia Vau i Dejës: Anton Dodani me nr. 44 rendor në bazë të vendimit më nr. 572 datë 06.06.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Prodhim dhe shitje të narkotikëve". Në bazë të nenit 283/1 K.p dënohet me 3 vjet dhe 4 muaj burgim.

Referuar gërmes "a", të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë brenda apo jashtë republikës së Shqipërisë për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 283/1 të K.P (Prodhim dhe shitje të narkotikëve).

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar/ dënuar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

Për personat që parashikohen nga shkronja "a", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit për personat që parashikohen në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës.

Referuar klasifikimit të veprës penale (i deklaruar fajtor për veprën penale "Prodhim dhe shitje të narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 K.p dënohet me 3 vjet dhe 4 muaj burgim), periudha e ndalimit për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, zgjatë gjatë gjithë jetës.

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturës, referuar nenit 10 pika 1, germa "c" të ligjit nr. 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e z. Anton Dodani.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë, Përrenjas, Mirëditë, Kavajë, Rrogozhinë, Skrapar, Maliq, Pogradec, Pustec, Polican, Gramsh, Kucovë, Fushë Arrës, Vau i



Nr. 561 i vendimit Data 18.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Dejës, Pukë, Delvinë, Berat, Përmet, Mallakastër, Bulqisë, Këlcyrë, Sarandë, Cërrik, Klos, Dropull, Krujë, Kurbin, Gjirokastër, Belsh, Memaliaj, Finiq, Shijak, Libohovë të Partisë Socialiste të Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019. KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Vau i Dejës nga nr. 1 deri 47 rendor duke zevendësuar nr. 44 z. Anton Dodani.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Të refuzojë kandidaturën e z. Andon Dodani me nr. 44 Rendor për këshillin e bashkisë Vau i Dejës, qarku Shkodër, Partia e Socialiste e Shqipërisë.
2. Njoftimin e Partisë Socialiste të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidatëve.
3. Njoftimin e KZAZ-së përkatëse për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë , Përrenjas, Mirëditë , Kavajë, Rrogozhinë, Skrapar, Maliq, Pogradec, Pustec, Polican, Gramsh, Kucovë, Fushë Arrës, Pukë, Delvinë, Berat, Përmet, Mallakastër, Bulqisë, Këlcyrë, Sarandë, Cërrik, Klos, Dropull, Krujë, Kurbin, Gjirokastër, Belsh, Memaliaj, Finiq, Shijak, Libohovë, Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
4. Njoftimin e KZAZ nr. 06 të vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Vau i Dejës nga nr. 1 deri 47 rendor duke zevendësuar nr. 44 rendor z. Anton Dodani.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 561 i vendimit Data 18.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak , të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.